V E N D I M
Nr.191, datë 22.3.1993

PËR SISTEMIN E BLERJEVE PUBLIKE DHE VEPRIMTARINË E BLERJES DHE TË SHËRBIMEVE QË KRYEJNË NDËRMARRJET DHE INSTITUCIONET QË FINANCOHEN NGA BUXHETI I SHTETIT

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë dhe të Ministrisë së Tregtisë dhe Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të krijohet pranë Ministrisë së Tregtisë dhe të Bashkëpunimit Ekonomik me jashtë sektori i blerjeve publike me detyrë krijimin dhe organizimin e sistemit të ri të blerjeve publike.

2. Ndërmarrjet dhe institucionet buxhetore lejohen të kryejnë veprimtari blerjeje për mjetet kryesore, pajisje, mallra e materiale, si dhe të kryejnë shërbime, kundrejt pagesës, me të gjitha subjektet ekonomike shtetërore e private, vendase ose të huaja.

3. Të gjitha blerjet e mësipërme bëhen sipas fondeve buxhetore të miratuara dhe të detajuara që më parë nga ministritë e institucionet e tjera qendrore e lokale.

4. Vlerësimi i mallrave, materialeve dhe i shërbimeve, kur kanë çmime të miratuara, bëhet sipas këtyre çmimeve, kurse kur nuk kanë çmime të miratuara, vlerësimi dhe blerja do të vendoset nga një komision që ngrihet pranë institucionit ose ndërmarrjes, i cili zgjedh variantin më të leverdisshëm të ofertave. Komisioni që caktohet nga titullari, nuk duhet të ketë më pak se 5 veta, kur të bëjë pjesë zëvendëstitullari dhe specialistë të fushave të ndryshme.

Titullari shqyrton dhe miraton dokumentacionin e paraqitur nga komisioni.

Veprat e artit vlerësohen sipas kritereve që cakton Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe Sporteve, duke iu përmbajtur procedurave të këtij vendimi.

5. Kriteret e hollësishme të zgjedhjes së ofertës më të mirë dhe procedurat përkatëse, duke përfshirë edhe blerjet nga ndërmarrjet shtetërore, përcaktohen në udhëzim të Ministrisë së Tregtisë dhe të Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë, të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë brenda muajit maj të vitit 1993.

6. Blerja e mjeteve kryesore, makinerive dhe pajisjeve të reja të sigurohen me katalogë e garanci për një periudhë, kurse për blerjen e objekteve të përdorura, pasi të shqyrtohen në të njëjtën mënyrë siç përcaktohet në pikën 4 të këtij vendimi, të merret mendimi dhe nga specialistë teknikë. Komisioni në këtë rast sigurohet për dokumentacionin që paraqesin subjektet, duke përfshirë edhe dokumentacionin e blerjes në origjinë ose atë të zhdoganimit.

7. Forma e pagesës do të jetë vetëm ajo me urdhërxhirimi në llogarinë e shitësit. Për blerje mallrash e materialesh deri në 10.000 lekë, likuidimi mund të bëhet me lekë në dorë ose me çek, po gjithmonë në bazë të një urdhërblerjeje të nënshkruar nga zyrtarët përkatës të financës dhe të miratuar nga titullari. Në këtë rast blerësi duhet t'i kërkojë shitësit të lëshojë një faturë ose dokument tjetër për sasinë dhe çmimin e blerjes.

8. Për shkeljet e dispozitave të këtij vendimi, kur nuk formojnë vepër penale, personat fajtorë dënohen për kundërvajtje administrative me gjobë deri në 4.000 lekë.

Të drejtën e gjobës e kanë inspektorët e drejtorive të financës të ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore dhe të organeve të pushtetit lokal. Kundër vendimit për dënim me gjobë mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve, përkatësisht te përgjegjësi i seksionit të financës në organet e pushtetit lokal dhe te drejtuesi i financës në ministri ose institucione të tjera qendrore, akti i të cilëve është i formës së prerë.

9. Ministria e Tregtisë dhe e Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Eknomisë, brenda muajit maj të vitit 1993, të paraqesë në Këshillin e Ministrave platformën e punës për krijimin e sistemit të blerjeve publike dhe platformën e legjislacionit përkatës.

10. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.400, datë 17.11.1990 "Për blerjen dhe kryerjen e shërbimeve jashtë sektorit shtetëror", udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr.10, datë 29.12.1983 "Për shpenzimet e nevojshme për pajisjen e zyrave" së bashku me ndryshimet që i janë bërë këtij udhëzimi

me udhëzimet nr.1, datë 13.8.1984 dhe nr.4, datë 26.9.1984, si dhe udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr.4, datë 22.3.1993 "Për plotësimin e nevojave për konfeksione, tekstile, prodhime lëkure e këpucë të institucioneve buxhetore", shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi